

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për krime të rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi me anëtarët e trupit – gjyqtarët: Xheladin Osmani dhe Artan Sejrani, me procesmbajtësen Ardiana Reshtani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh. A. nga fshati P. Komuna e S., për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë publike të Qarkut në Prizren PP.nr.184/10 të datës 28.01.2011, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.E. G., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat N. Q., më datën 31.03.2017, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

XH. A., nga i ati T. dhe e ëma S. – e lindur T., i lindur më *data e lindjes...* në fshatin M. Komuna e S., me banim në fshatin P. Komuna e S. – tani me punë të përkohshme në Londër, e ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor, i martuar – i ati i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në arrest shtëpiak prej datës 03.10.2010 deri më 28.01.2011 dhe në paraburgim prej datës 17.02.2017 deri më 31.03.2017.

ËSHTË FAJTOR

Se më datën 03.12.2010 rrethë orës 06:45 minuta në fshatin Sh. Komuna e S., me dashje tenton ta privoi nga jeta të dëmtuarin J. K. në atë mënyrë që së pari e godet me thikë duke ia shqyer jaknën në trup dhe pastaj hynë në automjetin e tij të markës “Opel Calibra” dhe me pjesën e përparme e godet të dëmtuarin J. duke e rrëxuar në tokë, del prej automjetit dhe sërish me këmbëngulësi i vërsulet me thikë duke iu drejtuar me fjalët “se do të jetë i vdekur”, me ç rast i shkakton lëndime të rënda trupore në trup, në nyjen shpatullore, në kofshën e majtë të shoqëruar me dhimbje koke dhe tronditje trupore të përcjellur me turbullim.

-Këso dore ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK.

Andaj gjykata konform nenit 3, 6, 34,36,37,38,64,73,146 lidhur me nenin 20 të KPK, e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 18 /tetëmbdhjetë/ muajve, në të cilin dënim me burgim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 03.10.2010 deri më dt.28.01.2011 dhe në paraburgim prej datës 17.02.2017 gjer më 31.03.2017.

I dëmtuari J. K. për realizimin e kërkesës pasuroro- juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari Xh. A. që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale – paushalin gjyqësor në shumën prej 500 Euro, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria publike e Qarkut në Prizren me aktakuzën PP.nr.284/10 të datës 28.01.2011 e ka akuzuar të akuzuarin Xh. A. për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK. Gjatë shqyrtimit gjyqësor – në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit Mehdi Sefa ka ngelur në tërësi pranë aktakuzës së lartëcekur duke shtuar se pas një mosmarrëveshje paraprake që ka patur me të dëmtuarin lidhur me një rrëmbim të vajzës së vëllaut i akuzuari e godet të njejtin me skalper ashtuqë ia pret jaknen në trup pastaj hynë në automjetin e tij “Opel Calibra” dhe me pjesën e parë të automjetit e godet vrullshëm J. me ç rast thehet edhe shofer shajbna. Pasi e rrëxon atë del prej automjetit dhe prap tregon një këmbëngulësi duke u drejtuar në drejtim të dëmtuarit J. K. me thikë me ç rast i njejtin pëson lëndime të rënda trupore të përshkruara si në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, andaj propozon që trupi gjykues ta shpall fajtor dhe ta gjykon sipas ligjit duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe se si rrethanë lehtësuese ta merrë parasysh pendimin e të akuzuarit dhe pajtmin me të dëmtuarin, se kemi të bëjmë me një njeri familjar e që nuk ka qenë i dënuar me parë.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokat N. Q. ka deklaruar se aktakuza e Prokurorisë së Qarkut në Prizren as juridikisht dhe as faktikisht nuk mund të qëndroi dhe se nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ditën kritike ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK. Kjo nga arsyeja se në asnjë mënyrë nuk është

vërtetuar qëllimi që ta privoi nga jeta. Konstatimi në aktakuzë se pas momentit kur i dëmtuari rëxohet nga goditja me automjet i akuzuari del prej automjetit dhe sërish me këmbëngulësi vërsulet me thikë, nuk është vërtetuar, ky konstatim nuk qëndron dhe nga vet provat që janë propozuar nga prokuroria, gjë të cilën nuk e ka thënë e as nuk e ka deklaruar as vet i dëmtuari. Asnjëri nga dëshmitarët nuk ka deklaruar se i akuzuari ka patur thikë në dorë. Edhe vet pala e akuzës – prokurori duke iu referuar provave përmend një skalper, që është pjesë e provave. Dëshmitari S. J. në deklarinimin e tij në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.08.2011 ka deklaruar se nuk ka parë thikë në dorën e të akuzuarit. Konsideron se në rastin konkret mund të formohen elementet e veprës penale sulmi nga neni 187 i KP, që në kohën kur është kryer vepra penale nuk e din se a ka qenë e përcaktuar me kodin e vjetër ose më e rënda për të mbrojturin e tij ka mundur që ta kryejë veprën penale të lëndimit të rëndë trupor nga neni 154 par.1. të KPK. Në këto rrethana kërkon që trupi gjykues të akuzuarin në mungesë të provave ta liroi nga akuza ose që ta shpall fajtor pas ricilësimit të veprës penale si sulm ose si lëndim i rëndë trupor. Me pohimet e mbrojtësit është pajtuar edhe vet i akuzuari Xh. A..

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 15.08.2011 e ka ndëgjuar të dëmtuarin J. K. i cili ka deklaruar se punon si ndërtimtar dhe se ditën kritike ka qenë duke shkuar në punë dhe se ishte duke pritur shefin që të vjen dhe ta merr në fshatin Sh..I akuzuari Xh. A. ka qenë duke pirë kafe në një kafiteri përtej rrugës në një largësi prej 70-80 metra, drejtëpërdrejtë ka ardhur dhe e ka sulmuar, e ka nxjerrë thikën dhe ia ka shkyer xhakëtën. Ka deklaruar se i akuzuari e ka kërcnuar se do ta vret, e ka sharë me nënë dhe motra dhe i ka thënë: “ki me qenë i vdekur”. Nuk ka patur ndonjë mosmarrëveshje me këtë familje dhe se Xh. nuk ka thënë se pse po e sulmon, me një thikë të gjatësisë 20 centimetra a ka godit në xhakëtë në anën e majtë, me ç rast i është shkyer xhaketa por nuk ka marrë lëndime. Më vonë derisa ka qenë duke e pritur shefin për punë ka ardhur Xh. A. me makinë dhe e ka godit në anën e majtë të trupit dhe se i njejtë ka qenë në parking kur e ka goditur dhe ate e ka goditur në këmbë, në gju dhe në shpatull të krahut të anës së majtë dhe në kokë me ç rast nga goditja është thyer xhami i përparmë i automjetit. Pasiqë e ka goditur me automjet ka dalë prej automjetit sërish me thikë dhe i ka thënë:”para vitit të ri do të jesh i vdekur” dhe se gjatë kësaj kohe kanë qenë prezent A. dhe R. ndërsa S. nuk ka qenë. Pas rastit të ndodhur ka kuptuar se punon te miqtë të cilët kanë patur një mosmarrëveshje me Xh. për një vajzë të vëllaut të Xh.. Ka deklaruar se familja e tij së pari ka kontaktuar me familjen e të akuzuarit pas kësaj edhe ata kanë ardhë dhe kanë kërkuar falje, mirëpo, deri më tani nuk e kanë pranuar këtë kërkim falje pasiqë kanë pritur që rasti të përfundojë në gjykatë.

Gjatë shqyrtimit të datës së lartëcekur është ndëgjuar edhe dëshmitari S. J. i cili ka deklaruar se ditën kritike e ka pa Xh. dhe J. duke u përleshur dhe se J. ka patur një shtrafciger në dorë ndërsa Xh. e ka pasë një skalper. Se a ka pasë fjalosje paraprakisht në mes tyre nuk ka ndëgjuar, poashtu nuk din se cili ka sulmuar i pari sepse ai vetëm i ka pa duke u përlesh. Dëshmitari vetëm ka ndërmjetësuar që ti ndanë, nuk ka vërejtur që jakna e të akuzuarit ka qenë e shkyer vetëm ka vërejtë që të dytë kanë qenë me tesha të punës, me tesha të vjetra si shkohet në punë për të punuar. Përndryshe nuk e ka parë kur Xh. me automjet e ka godit J..

Në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 10.03.2017 është ndëgjuar dëshmitari A. Q. i cili ka deklaruar se J. K. e një si koleg pasiqë së bashku kanë punuar në ndërtimin e një ndërtese në Prizren në afërsi të Stacionit të autobusave dhe se ditën kritike ka qenë para Qendrës tregtare “P...” në afërsi të fshatit Sh. kur ka vërejtë se Xh. A. dhe J. K. ishin duke u përlesh në mes vehdi, kështuqë ai ka ndërhyrë e ka tërhjekë Xh. A. ndërsa S. J. J. dhe se së bashku me J. kanë kaluar në anën tjetër të rrugës që ta presin autobusin. Pastaj ka ardhur Xh. A. me automjet dhe e ka godit J. në pjesën e këmbëve, me ç rast J. ka ra përmbi shofer shajbne. Se çka ka ndodhë më tutje nuk e din pasiqë të njejtin e ka marrë shefi me automjet dhe ka shkuar në punë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës së lartëcekur është ndëgjuar edhe eksperti mjeko-ligjor Dr.C. M. i cili ka ngelë në tërësi pranë mendimit të dhënë me shkrim të datës 16.12.2010 në lidhje me lëndimet e të dëmtuarit J. K., e të cilin mendim e ka bazuar në raportet mjekësore nga QKMF Therandë me nr. të protokolit 20118 të datës 03.12.2010, si dhe në raportin mjekësor të Qendrës emergjente në Prizren me nr.26983 të datës 03.12.2010, duke sqaruar se lëndimet në anën e majtë të trupit, nyjen shpatullore dhe kofshën e majtë, nyjen e dorës së majtë janë të klasifikuara si shtypje të shoqëruara me gërvishje e të shkaktuara nga dinamika e veprimit të pjesës mbretëse të mjetit të fortë, furishëm, fuqishëm, si nga rrethanat që janë të përshkruara nga makina ashtu edhe nga goditja në tokë gjatë rrotullimeve eventuale të dëmtuarit, pra, çdo mjet që ka peshë dhe furi jep lëndime të këtilla. Lëndimet në tërësi janë lëndime të karakterit të rëndë trupor pa elementin e rrezikshmërisë për jetë në momentin e shkaktueshmërisë por me zvogëlim të përkohshëm fizik në pjesët e atakuara.

I akuzuari Xh. A. në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor të datës 30.03.2017 ka deklaruar se ngelë në tërësi pranë deklaratës së dhënë në Prokurorinë e Shtetit dhe se gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike ka patur një mosmarrëveshje verbale me J. K. rrethë një goce të vëllaut të tij dhe se ditën kritike i dëmtuari e ka patur kaçavidën në dorë ndërsa i akuzuari metrin dhe skalpelin mirëpo nuk ka tentuar me i ra me to. Është e vërtet që të dëmtuarin e ka goditur me automjet me ç rast është thyer shofershajbna e automjetit të tij dhe se pas goditjes është larguar nga vendi i ngjarjes për shkak të frigës. I vjen keq për rastin e ndodhur dhe se pas 6 apo 7 muajve pas ngjarjes së ndodhur janë pajtuar me të dëmtuarin. Ditën kritike ai ka shkuar në drejtim të dëmtuarit dhe se qëllimi i tij ka qenë vetëm që të sqarohet për gocën e vëllaut.

Në bazë të provave të lartëcekura, pas vlerësimit të secilës provë një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se më datën 03.12.2010 rrethë orës 06:45 minuta në fshatin Sh. Komuna e S., me dashje tenton ta privoi nga jeta të dëmtuarin J. K. në atë mënyrë që së pari e godet me thikë duke ia shqyer jaknën në trup dhe pastaj hynë në automjetin e tij të markës “Opel Calibra” dhe me pjesën e përparme e godet të dëmtuarin J. duke e rrëxuar në tokë, del prej automjetit dhe sërish me këmbëngulësi i vërsulet me thikë duke iu drejtuar me fjalët” se do të jetë i vdekur”, me ç rast i shkaktonte lëndime të rënda trupore në trup, në nyjen shpatullore, në kofshën e majtë të shoqëruar me dhimbje koke dhe tronditje trupore të përcjellur me turbullim.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e vërtetoi në bazë të deklaratës së të dëmtuarit J. K. i cili ka deklaruar se ditën kritike pa kurrfarë arsye e ka sulmuar i akuzuari së pari me thikë duke ia shkyer jaknën e pastaj edhe duke e goditur me automjet dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore më afër të përshkruara dhe të shpjeguara nga ana e ekspertit mjeko-ligjor dr.C. M..Kjo gjendje faktike e lartëcekur u vërtetua edhe nga deklarata e dëshmitarit A. Q. i cili ka deklaruar se ka vërejtë kur Xh. A. dhe J. K. ishin duke u përlesh në mes vehdi dhe se ai ka ndërhyr që ti ndan dhe se pastaj ka ardhur Xh. A. me automjet dhe e ka godit J. në pjesën e këmbëve, me ç rast J. ka ra përmbi shofer shajbne. Gjendja e këtillë faktike u vërtetua edhe nga deklarata e vet të akuzuarit i cili ka pranuar se është e vërtet që të dëmtuarin e ka goditur me automjet me ç rast është thyer shofershajbna e automjetit të tij dhe se pas goditjes është larguar nga vendi i ngjarjes për shkak të frigës.

Gjendja e lartëcekur faktike u vërtetua edhe nga provat materiale-raportet mjekësore si dhe mendimi i ekspertit mjeko-ligjor dhe pohimet e tij të cekura gjatë shqyrtimit gjyqësor në lidhje me karakterin dhe natyrën e lëndimeve të të dëmtuarit J. K. i cili ditën kritike ka fituar lëndime të rënda trupore në anën e majtë të trupit, nyjen shpatullore dhe kofshën e majtë, nyjen e dorës së majtë e të cilat janë të klasifikuara si shtypje të shoqëruara me gërvishje e të shkaktuara nga dinamika e veprimit të pjesës mbretëse të mjetit të fortë, furishëm, fuqishëm, si nga rrethanat që janë të përshkruara nga makina ashtu edhe nga goditja në tokë gjatë rrotullimeve eventuale të dëmtuarit.

Poashtu ky fakt u vërtetua edhe nga foto dokumentacioni dhe formulari për inventarizimin e automjetit ku vërtetohet se vetura e të akuzuarit Xh. A. e markës “Opel Calibra” e ka të dëmtuar xhamin e përparmë, dritën e parë të anës së majtë si dhe pjesën afër derës – ana e majtë,gjë që e vërteton edhe faktin se i akuzuari Xh. A. e ka goditur me pjesën e përparme të veturës të dëmtuarin J. K. me ç rast i ka shkaktuar lëndimet e lartëcekura trupore.Andaj,edhe bazuar në këtë fakte gjykata edhe ia fali besimin deklaratës së të dëmtuarit dhe dëshmitarit të lartëcekur,pasiqë deklaratat e tyre përputhen edhe me provat materiale-dëmtimet në automjetin e të akuzuarit,që e vërteton edhe faktin se lëndimet e rënda trupore i akuzuari i ka fituar nga goditja me automjet,fakt të cilin e ka pohuar edhe vet i akuzuari në mbrojtjen e vet.

Andaj, bazuar në të lartëcekurat gjykata edhe ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit Xh. A. formohen elementet qenësore të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, pasiqë i akuzuari ditën kritike me dashje, me automjetin e tij të markës “Opel Calibra” e godet me pjesën e përparme të automjetit të dëmtuarin J. K. duke e rrëxuar në tokë me ç rast nga goditja thehet edhe xhami i përparmë i automjetit – shofershajbna ndërsa i dëmtuari merrë lëndime të rënda trupore më afër të përshkruara nga ekspertiza dhe pohimet e ekspertit të lartëcekur. Se ekziston dashja e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale vërtetohet me vet faktin se i akuzuari pasi që së pari e sulmon me thikë,nuk mjaftohet me atë,por edhe me automjet e godet të dëmtuarin dhe se mbrojtja e të akuzuarit se qëllimi i tij ka qenë vetëm që të sqarohet në lidhje me gocën e vëllaut për gjykatën është e papranueshme pasi që i akuzuari po të kishte dashur që të sqarohet me të vërtet ashtu siq deklaroi, nuk e kishte goditur me automjet dhe të lartohej nga vendi i ngjarjes por do të ishte munduar që të sqarohet me fjalë,që do të thotë se i

akuzuari ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe se ka dëshiruar kryerjen e saj. Andaj edhe bayuar në këtë, gjykata nuk ia fali fare besimin, mbrojtjes së këtyllë të akuzuarit në këtë drejtim, me arsyetim se është e pabazë dhe në kundërshtim me provat tjera të lartëcekura të administruara.

Nga provat e vlerësuara të lartëcekura vërtertohet dashja dhe vendosmëria e të akuzuarit për të kryer veprën penale. Kjo nga fakti se i akuzuari ka sulmuar personin duarthatë-e ka goditur me aztomjet,i cili nuk ka patur me çka të sulmoj as me çka të mbrohet.Këtë fakt ai e ka ditur fare mirë,mirëpo përkundër kësaj ndërmerr veprimet e lartëcekura dhe me dashje e kryenë veprën penale për të cilën edhe është shpallur fajtor.

Andaj,bazuar në provat e lartëcekura gjykata edhe ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit krijohen elementet qenësore të veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, për çka edhe gjeti se është penalo-juridikisht pergjegjës dhe e gjykoj me dënim me burgim si në dispozitiv.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 64 të KPK, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë,motivet nga të cilat është kryer vepra, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh qëndrimin e tij korrekt, moshën relativisht të re dhe pendimin për kryerjen e veprës penale,si dhe faktin se prej kohës së kryerjes së veprës penale-viti 2010,e gjer më sot i akuzuari nuk ka ra në konflikt me ligjin që do të thotë se edhe kjo kohe e kaluar ka ndikuar në përmirësimin e sjelljeve të tija dhe në risocializimin e tij. Pasiqë rrethana rënduese nuk gjeti,andaj, është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet konformë nenit 34 të KPK,se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur,si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarit ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale.Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në shërbim të preventivës së përgjithshme,posaqërisht të asaj të posaçme,se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë,përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë konform nenit të lartëcekur në të gjitha segmentet e tij. Dënimi i shqiptuar për kah lloji dhe lartësia është në harmoni me rrethanat e rastit,i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit konform dispozitës së lartëcekur. Dënimi i shqiptuar të akuzuarit sipas gjetjes së gjykatës është në harmoni dhe në baraspeshë me peshën e veprës së kryer penale dhe se kur të mirret parasysh shkalla e dëmtimit të vlerës së mbrojtur,mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale,dënimet e këtylla paraqiten si të domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimit të dënimit,me to shprehet gjykimi i shoqërisë për shkak të veprës së kryer penale dhe forcohet obligimi i respektimit të ligjit.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 99 par.2 pika 6 në lidhje me nenin 102 par.1 të KPPK.

Vendimi mbi kërkesën pasuroro-juridike është marr konform nenit 102 par.2 të KPPK.

Gjykata nuk ka vendosur për shpenzimet e udhëtimit dhe për fitimn e humbur të dëshmitarit A. Q.,pasiqë në këtë drejtim nuk ka parashtruar prova.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për krime të rënda
Më dt.31.03.2017. P.nr.52/10

Proçesmbajtësja
Sheqere Braha

Kyetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.